



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

U R D H Ë R

Nr 166 Date 29.07.2005

PËR

**KRIJIMIN E SEKSIONIT TË POLICISË GJYQËSORE PRANË DREJTORISË
SË PËRGJIMEVE TË TELEKOMUNIKIMIT**

Me synim, fillimin e funksionimit të përgjimit të telekomunikimeve procedurale penale ne Qendrën Kombëtare të Përgjimeve;

Në mbështetje, të nenit .223 e vijues të K. Pr. Penale, nenit 23 të ligjit nr. 9157 datë 4. 12. 2003 *Për përgjimin e telekomunikimeve, të nenit 8 pika 2 të ligjit nf. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë* dhe nenit 8/1 e vijues të ligjit nr. 8677 datë 02. 11. 2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", si dhe pasi u morr pëlqimi riga Ministri i Rendit Publik për numrin organik të oficerëve. te Policisë së Shtetit në këtë strukturë;

URDHËROJ:

1. Krijimin e Seksionit të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjimit të Telekomunikimeve në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Struktura organike e këtij seksioni të policisë gjyqësore të jetë, si më poshtë:
 - 2.1. Oficerë të' policisë gjyqësore-juristë 3 (tre).
 - 2.2. Oficerë të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit 6 (gjashtë).
3. Me këtë urdhër të njihet Drejtoria e Personelit dhe Inspektimin e kësaj Zyre dhe strukturat e Ministrisë së Rendit Publik, për të kryer procedurat përkatëse të përzgjedhjes dhe caktimit të oficerëve të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit në këtë seksion.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU